66	17.05.2023	Kërkesë për informacion për Rregjistrim në programin e profesionistëve të shëndetësisë	22.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se ju mund te aplikoni per sherbimin Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë. Bashkelidhur linku: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039 Dokumente që ngarkohen nga aplikanti: - Leje e ushtrimit të profesionit lëshuar nga Urdhri Profesional përkatës. Hapat e procedures: - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë"; - Klikoni butonin "Përdor"; - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular; - Ju do të njoftoheni me e-mail dhe tek seksioni "Dokumentet e mia" në e-Albania për regjistrimin. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 10 ditë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Ose na kontaktoni ne live chat, ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
67	22.05.2023	Kërkesë për informacion Aplikim për licencë për arsim parauniversitar	22.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se e ju mund te aplikoni per sherbimin Aplikim për licencë për arsim parauniversitar(kopsht/shkollë 9-vjeçare/shkollë e mesme) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9750 Hapat e procedures - Identifikohuni si biznes në portal - Zgjidhni shërbimin Liçensim për "Aplikim për licensë për arsim parauniversitar(kopsht/shkollë 9-vjeçare/shkollë e mesme)" - Klikoni butonin "Përdor" - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi adresën e biznesit dhe ngarkoni dokumentet e nevojshme të kriterëve të licencës. - Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit. - Merrni numrin e çështjes në përgjigje të dërgimit të aplikimit, me të cilën mund të gjurmoni më pas çështjen e hapur duke përdorur shërbimin "Gjurmimi i çështjeve nga Qendra Kombëtare e Biznesit (licenca)". - Dërgoni me postë versionin origjinal vetëm për dokumentet e skanuara gjatë aplikimit online. - Sportelisti verifikon dokumentet e aplikimit dhe nëse ato janë të gjitha të nënshkruara elektr	E plotë	Nuk ka

				onikisht, e konfirmon çështjen duke e kaluar te regjistruesi. Nëse një pjesë e dokumenteve janë të panënshkruara elektronikisht (pra, të skanuara nga origjinali), atëherë sportelisti e le pezull çështjen deri në mbërritjen e dokumenteve origjinale. - Pasi dokumentet origjinale mbërrijnë në QKB, sportelisti verifikon që ato janë të njëjta me versionin e skanuar të dërguar gjatë aplikimit online. Më pas konfirmon krijimin e çështjes (sistemi i brendshëm i QKB-së gjeneron LC-në përkatëse dhe lajmëron aplikantin me e-mail). - Çështja i shfaqet regjistruesit të QKB-së për trajtim të mëtejshëm. Regjistruesi proceson aplikimin dhe pas aprovimit të tij, çështja i kalon ministrisë për shqyrtim. Në rast se regjistruesi nuk e aprovon aplikimin, aplikanti njoftohet me e-mail për arsyen e refuzimit. - Ministria shqyrton aplikimin dhe merr vendim aproves ose refuzues për çështjen. Në rast refuzimi, aplikanti njoftohet me e-mail edhe mbi arsyen. - Në rastin e aprovimit të aplikimit nga ministria, licenca përkatëse ose aktivizohet direkt prej saj kur dhënia e licencës është pa pagesë ose shfaqet në radhën e punës të sportelistit të QKB-së për ngarkimin e mandatit të pagesës. - Pas kryerjes së pagesës nga aplikanti, licenca aktivizohet nga sportelisti i QKB-së. Sportelisti vijon me gjenerimin e dokumentit të licencës, e nënshkruan atë elektronikisht dhe e dërgon në seksionin “Dokumentet e mia” të “Hapësira ime”. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 14 dite pune Periudha e vlefshmërisë Pa afat Kostot Pagesa për këtë lloj license percaktohet nga Ministria përkatëse në momentin e aktivizimit të titullit të licensës. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 11 nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.		
68	23.05.2023	Kërkesë për informacion për Shpallje martesë midis dy shtetasve shqiptarë	23.05.2023	Përsëritet, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon: Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentet e	E plotë	Nuk ka

				nevojshëm për shpalljen e martesës janë:prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese” ,fotokopje e dokumentit të identifikimit; Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Lidhur me pyetjen tuaj , ju bëjmë me dije se kjo është procedura e vetme ligjore për shpalljen e martesës.pra nuk ka procedure të përsheptuar .Procedura vijon si me lartë.Përsa i përket certifikatës së martesës e merrni në moment një dokument të tillë,por në llogarinë tuaj e-albania sigurisht vonon dy-tre ditë për tu hedhur në sistem.		
69	24.05.2023	Kërkesë për informacion për Gjenerim passwordi	24.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Hapni një adresë të re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al : - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës. Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhblllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
70	24.05.2023	Kërkesë për informacion për Licencë për formim profesional	24.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju informojmë se për të dhënë diplomë ose certifikatë në fushën e gjuhëve të huaja, duhet të aplikoni shërbimin " Aplikim për licencë për formim profesional " përmes platformës e-Albania në linkun e mëposhtëm : https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9740 Fillimisht, Ju (ose personi i cili do të aplikojë për licencë) duhet të krijojë	E plotë	Nuk ka

				një llogari biznesi në e-Albania. Në vijim, mund të aplikoni, duke klikuar për shërbimin e kërkuar "Aplikim për licencë për formim profesional " dhe aplikoni për shërbimin duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit. Dërgoni me postë ose dorëzoni në sportelin e QKB-së versionin origjinal vetëm për dokumentet e skanuara gjatë aplikimit online. - Sportelisti verifikon dokumentet e aplikimit dhe nëse ato janë të gjitha të nënshkruara elektronikisht, e konfirmon çështjen duke e kaluar te regjistruesi. Nëse një pjesë e dokumenteve janë të panënshkruara elektronikisht (pra, të skanuara nga origjinali), atëherë sportelisti e le pezull çështjen deri në mbërritjen e dokumenteve origjinale. - Pasi dokumentet origjinale mbërrijnë në QKB, sportelisti verifikon që ato janë të njëjta me versionin e skanuar të dërguar gjatë aplikimit online. Më pas konfirmon krijimin e çështjes (sistemi i brendshëm i QKB-së gjeneron LC-në përkatëse dhe lajmëron aplikantin me e-mail). - Çështja i shfaqet regjistruesit të QKB-së për trajtim të mëtejshëm. Regjistruesi proceson aplikimin dhe pas aprovimit të tij, çështja i kalon ministrisë për shqyrtim. Në rast se regjistruesi nuk e aprovon aplikimin, aplikanti njoftohet me e-mail për arsyen e refuzimit. - Ministria shqyrton aplikimin dhe merr vendim aprovues ose refuzues për çështjen. Në rast refuzimi, aplikanti njoftohet me e-mail edhe mbi arsyen. - Në rastin e aprovimit të aplikimit nga ministria, licenca përkatëse ose aktivizohet direkt prej saj kur dhënia e licencës është pa pagesë ose shfaqet në radhën e punës të sportelistit të QKB-së për ngarkimin e mandatit të pagesës. Pas kryerjes së pagesës nga aplikanti, licenca aktivizohet nga sportelisti i QKB-së. Sportelisti vijon me gjenerimin e dokumentit të licencës, e nënshkruan atë elektronikisht dhe e dërgon në seksionin "Dokumentet e mia" te "Hapësira ime" Gjithashtu aplikanti mund të tërheqë dokumentin e licencës në sportel. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e komunikimit (online chat); Nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
71	24.05.2023	Kërkesë për informacion për	24.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se duhet të paraqiteni tek Njësia Juaj Administrative për të plotësuar	E plotë	Nuk ka

		Përfitimi i ndihmës ekonomike		formularin për përfshirjen në skemën e ndihmës ekonomike. Atje do të informoheni për kriteret dhe dokumentacionin që duhet të dorëzoni. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
72	25.05.2023	Kërkesë për informacion për Aplikim AV0	25.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj bëjmë me dije se për problemin që referoni, mund të bëni një kërkesë me shkrim ku të shpjegoni problematikën dhe të aplikoni AV0. Për të plotësuar një AV ose e quajtur ndryshe “Akt Verifikimi” ju duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkonti shërbimin që ju keni aplikuar së fundmi, shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV. Pas kërimit të shërbimit ju duhet të klikoni “Përdor” dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni opsionin për plotësimin e AV-se. Ngarkoni kërkesën me shkrim dhe më pas opsioni Dërgo. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
73	25.05.2023	Kërkesë për informacion rreth Institucionit ADISA	25.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju mund të hulumtoni në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ për informacionin që kërkonti. Gjithashtu ju bëjmë me dije se, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” Neni 11 pika 1 dhe 4, ju duhet të paraqisni një kërkesë për informacion në rrugë elektronike ku të paraqisni sakte identitetin tuaj, të sqaroni qëllimin mbi këtë informacion të kërkuar dhe të bashkëlidhni në të edhe kartën Tuaj ID së bashku me nënshkrimin tuaj. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
74	26.05.2023	Kërkesë për informacion për zgjidhje martesë	26.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shkurorëzimi ose zgjidhja e martesës zyrtarizohet në gjykatë. Në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit të gjykatës, martesa do të konsiderohet e zgjidhur. Regjistrimi shtetëror i shkurorëzimit kryhet nga zyra e gjendjes civile në mënyrën e përcaktuar për regjistrimin shtetëror të akteve të gjendjes civile. Me një kopje të vendimit, duhet të paraqiteni në zyrën e gjendjes civile, e cila do të lëshojë një certifikatë divorci. Një certifikatë divorci është një dokument që konfirmon zgjidhjen e martesës. Pas zgjidhjes së martesës, varësisht adresës ku do banoni, jeni e detyruar të bëni ndryshimin/saktësimin e vendbanimit. Pra, nuk përbën domosdoshmëri që	E plotë	Nuk ka

				të bëni ndryshimin e vendbanimit para zgjidhjes së martesës. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
75	27.05.2023	Kërkesë për informacion për shpallje martese	29.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se afati për shpalljen e martesës është 10 dite. Pas 10 ditësh ju keni mundësinë të lidhni martese brenda 1 viti. Pra, nëse ju e bëni kërkesën në Qershor dhe ktheheni brenda 1 viti, ju mund të kryeni lidhjen e martesës. Pas 1 viti nga shpallja e martesës, ju nuk mund të kryeni lidhjen martesore. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose në chatbox online në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ .	E plotë	Nuk ka
76	29.05.2023	Kërkesë për informacion zyrtar të pasurisë	29.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga Juaj në e-albania shërbimin: Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Procedura duhet të shoqërohet me një kërkesë me shkrim nga ana Juaj në format PDF, dhe Aktin e trashëgimisë së gjyshit ku përcaktohet se ju jeni një nga trashëgimtarët. Kërkesën dhe aktet do i ngarkoni në hapin e tretë të aplikimit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do t'Ju pajisë me informacionin që kërkontë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
77	29.05.2023	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	29.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë e biznesit, për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë. Nga adresa email me të cilën jeni regjistruar në e-albania, dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al : - foto të kartës ID - foto të certifikatës së regjistrimit (NIPTI)- emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës. Brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t'Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllkohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në	E plotë	Nuk ka

				numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
78	29.05.2023	Kërkesë për informacion për kopje dokumentesh	29.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kopjen e Aktit të trashëgimisë e merrni në zyrën noteriale ku është hartuar ky akt. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
79	29.05.2023	Kërkesë për informacion për mbyllje pensioni	29.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni në e-albania shërbimin "Mbyllje pensioni", nëse i ndjeri ka qenë pensionist. Për të bërë mbylljen e pensionit, duhet të aplikoni nga llogaria ndonjë familjari në e-albania shërbimin” Aplikim për mbyllje pensioni” në linkun e mëposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6162 Hapat e procedures: - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania - Zgjidhni shërbimin "Aplikim për mbyllje pensioni" - Klikoni butonin "Përdor". - Dokumentet origjinale që i keni bashkëlidhur gjatë aplikimit duhet të dërgohen me postë pranë DRSSH përkatëse. Ju lutem mbani në konsideratë që zarfi i përcjelljes së këtyre dokumenteve të shoqërohet me numrin e aplikimit tuaj Pavarësisht se me cilin ligj e keni përfituar pensionin, për mbylljen e tij aplikohet vetëm në këtë link.Pra. Gjatë aplikimit duhet të kishit ngarkuar faturën e shpenzimeve funerale, dhe faturën origjinale duhet ta dërgoni me postë pranë DRSSH. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
80	29.05.2023	Kërkesë për informacion për Regjistrimi i aktit të martesës	29.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se dokumenti i vetëm që duhet të regjistrojnë në gjendjen civile në Shqipëri është Akti i martesës me vulë apostile. Mënyra tjetër e regjistrimit të aktit të martesës është edhe online nga llogaria e tyre në e-albania nëpërmjet shërbimeve konsullore. Aplikim për regjistrim martese. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9768 Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti: - Certifikata e martesës, lëshuar nga autoritetet e huaja (e legalizuar ose pajisur me vulë apostile) - Përkthimi i certifikatës së martesës, i legalizuar ose pajisur me vulë apostile (nëse nuk e legalizoni apo apostiloni përkthimin e certifikatës,	E plotë	Nuk ka

				kërkohet që përkthimi në gjuhën shqipe të kryehet në konsullatë ose nëse është kryer përkthimi nga përkthyes të licensuar, duhet që konsulli të lëshojë "vërtetim përkthimi". (Tarifa e përkthimit apo vërtetimit të përkthimit është 10 euro për faqe dhe është detyrim i qytetarit aplikues) - Dokumente identifikimi, pasaportë e vlefshme udhëtimi ose letër njoftimi e bashkëshortëve. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit		
81	30.05.2023	Kërkesë për informacion për regjistrim i aktit të martesës	30.05.2023	Përsëritet, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se mënyra e regjistrimit të aktit të martesës nga vendi ku keni lidhur martesën, është online nga llogaria Juaj në e-albania, nëpërmjet shërbimeve konsullore. Aplikim për regjistrim martesë. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9768 Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti: - Certifikata e martesës, lëshuar nga autoritetet e huaja (e legalizuar ose pajisur me vulë apostile) - Përkthimi i certifikatës së martesës, i legalizuar ose pajisur me vulë apostile (nëse nuk e legalizoni apo apostiloni përkthimin e certifikatës, kërkohet që përkthimi në gjuhën shqipe të kryehet në konsullatë ose nëse është kryer përkthimi nga përkthyes të licensuar, duhet që konsulli të lëshojë "vërtetim përkthimi". (Tarifa e përkthimit apo vërtetimit të përkthimit është 10 euro për faqe dhe është detyrim i qytetarit aplikues) - Dokumente identifikimi, pasaportë e vlefshme udhëtimi ose letër njoftimi e bashkëshortëve. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose në online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
82	30.05.2023	Kërkesë për informacion për regjistrimin e kalimit të pronësisë	31.05.2023	Përsëritet, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, ju duhet të Kërkoni shërbimin R2 -“ Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ ” https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444 dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit.	E plotë	Nuk ka

				Në hapin e dytë duhet të shtoni edhe këto shërbime: L1- Lëshim certificate pronësie; I5- Lëshim kopje karte te pasurisë; I4- Lëshim kopje te fragmentit te hartës kadastrale. R6- Aplikim për regjistrimin e bashkimit, ndarjes apo pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme Dokumentacioni i nevojshëm për t'u ngarkuar është Certificate e pronësise dhe keto dokumenta qe na keni derguar dhe ne . Te gjitha keto dokumenta duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë. Ky aplikim nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit . Në fund klikoni opsionin “<i>Dërgo</i>”. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në Poste për të kryer pagesën dhe postimin e dokumentave. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
83	30.05.2023	Kërkesë për informacion për mundësi punësimi	31.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju lutem klikoni linkun: http://www.adisa.gov.al/mundesipunesimi/ për të parë vëndet vakante në ADISA, dhe informacionin përkatës për secilin pozicion. Në linkun e mesipërme do të gjeni edhe adresën e emailit ku duhet të dërgoni aplikimin tuaj për punësim. Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
84	30.05.2023	Kërkesë për informacion për njehsim i diplomës nga IAL	31.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se per te kryer njehsimin e diplomes tuaj ju duhet te aplikoni online per sherbimin Njësimi i diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë. Ky shërbim elektronik u vjen në ndihmë qytetarëve që aplikojnë për njësimin e certifikatave dhe diplomave të huaja të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, të cilat i përkasin niveleve nga 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në kualifikimet e niveleve 5 – 8 të Kornizës së Shqiptare të Kualifikimeve përfshihen Diploma Profesionale, Bachelor, Master, Specializime Afatgjata, si dhe Doktoratë. Pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), kryhen njësimet për: Diploma Profesionale, Bachelor,	E plotë	Nuk ka

				Master dhe Specializime Afatgjata. Ndërsa njësimi i diplomave të nivelit 8 - Doktoratë si dhe Njësimi i titujve akademikë kryhet pranë MAS. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë kryhet online nëpërmjet portalit e-Albania. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht në formatin elektronik (PDF me ngjyra) gjatë aplikimit online. Dokumentacioni i nevojshëm <i>Për njohjen e diplomave të huaja për ciklin e parë dhe të dytë, si dhe diplomat e specializimeve afatgjata, dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti:</i> - Diplomën/certifikatën, ose dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të pajisur me vulë apostile dhe të noterizuar, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës - Listën e notave dhe/ose suplementin e diplomës, të noterizuar, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës - Fotokopja e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj); - Mandat-pagesa (për rastet kur aplikanti kryen pagesën nëpërmjet bankës ose zyrave të postës shqiptare. http://qsha.gov.al/) Kostot Pagesa për njohjen dhe njësimin e certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë përveç aplikimeve të paraqitura nga refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, është 2000 (dy mijë) lekë dhe kryhet në llogarinë bankare të QSHA, të përcaktuar në faqen zyrtare të QSHA dhe e-Albania, në seksionin përkatës të njohjes së diplomave. Pagesa mund të kryhet gjatë aplikimit online nëpërmjet kartës së kreditit/debitit ose pranë bankave të nivelit të dytë apo Postës Shqiptare. Për refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, shërbimi ofrohet pa pagesë. Per te kryer aplikimin online, bashkelidhur gjeni linkun e aplikimit: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853 Ju lutemi lexojini me vemendje te gjithë udhezimet qe varrojne ne varesi te llojit		
--	--	--	--	--	--	--

				te diplomes qe keni! Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni ne chatbox online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ Faleminderit!		
85	31.05.2023	Kërkesë për informacion për shpallje martese	31.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se hapi i parë i lidhjes së martesës, është shpallja e martesës. Ju nuk keni bërë me dije nëse partnerët janë të dy shqiptarë apo të huaj. Procedura për të bërë shpalljen e martesës midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj është si më poshtë vijon : Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile; dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: certifikatë lindje; certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”; Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Kujdes! Shpallja e martesës është procedurë që nuk realizohet online. Për çdo pyetje ose	E plotë	Nuk ka

				paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
86	31.05.2023	Kërkesë për informacion për shpallje martese midis dy shtetasve shqiptare	31.05.2023	Përsëritet, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon: Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Pra shpallja bëhet në të dyja gjendjet civile ku kanë vendbanimin partnerët. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”; fotokopje e kartës së identitetit shqiptare Brenda afatit të vlefshmërisë” Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Lidhur me pyetjen Tuaj , ku citon se dëshironi të keni të pranishme motrën Tuaj, pamvarësisht mbiemrit që ajo mban, ka lidhje gjaku me Ju. Motra Juaj mund të jetë dëshmitare për partnerin Tuaj. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalën informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte në fashën orare 08.00 – 19.00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
87	30.05.2023	Kërkesë për informacion për kopje të fragmentit të hartës kadastrale	31.05.2023	Përsëritet, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përsëritet! Kam aplikuar në E-albania për kopje të fragmentit të hartës kadastrale me datë 13-05-23, dhe ende nuk kam një përgjigje. Përgjigja është kryer në bankë një ditë më vonë. Nr i	E deleguar	Nuk ka

				aplikimit eshte: 33425426-1000048-13052023 Ju lutem mund ta shikoni se pse ende nuk e kam marre kete sherbim? Faleminderit!		
88	31.05.2023	Kërkesë për informacion për Rimbursim shpenzimesh për shtetasit shqiptarë që ndërrojnë jetë jashtë vendit	31.05.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, ju bejme me dije dokumentacionin qe duhet te dergoni prane institucionit kompetent ne menyre qe te perfitoni rimbursimin e shpenzimeve. Dokumentet qe duhet te dorezoni jane: Dokumenti i vdekjes nga shteti ku ka ndodhur vdekja; Faturë, biletë apo dokument tjetër që vërteton se shpenzimet e transportit i kanë kryer familjarët apo të afërmit e të ndjerit; Vërtetim për vendin e varrimit në Shqipëri; Certifikatë vdekje nga zyra përkatëse e gjendjes civile në Shqipëri; Vërtetim nga banka i numrit të llogarisë bankare i personit të familjes që do tërheqë shpërblimin; Numër kontakti të personit që do të dërgojë dokumentacionin me qëllim komunikimin në rast mungesash * Numër kontakti të personit që do të dërgojë dokumentacionin me qëllim komunikimin në rast mungesash; Dokumentacioni i mësipërm duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar. Dokumentacioni në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar Dokumentet e mesiperme do te dergohen prane Zyrave te Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Rimbursimi i këtyre shpenzimeve bëhet brenda një viti nga dita e sjelljes së kufomës në Shqipëri Nëse e keni realizuar procedurën si më sipër dhe rimbursimi nuk ka kaluar ende në numrin e llogarisë që keni dërguar pranë MIE, lutemi kontaktoni ministrinë në faqen zyrtare: https://www.infrastruktura.gov.al/ Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka